



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223781

Datë: 05.07.2022

Numri i dokumentit: 03201673

K. Nr. 1001/21

Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, Gjyqtari Menderes Behluli, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit K.M nga fsh.K. Gjilan, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 7**, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr., 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, e konform nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119, dhe 48 pika 2, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë **05.07.2022** shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit K.M , nga babai i lindur me datë....., me nr personal....., në fsh.K. Gjilan, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën **10.09.2021** rreth orës **14:10** min, është takuar në territorin e fshatitnë rrugë duke transportuar dru bungu të njoma, të pa vulosura dhe pa fletëpercjellse me sasi prej 1.25 cm, me diametër 15-25 cm, dhe me gjatësi 1m, të cilat i transportonte me kamionet “**IVECO**”, me targa....., e që i ka shkaktuar dëm Agjencionit Pyjor në shumë prej 156.25 euro.

- me ç ‘veprim ka kryer veprën kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 7, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3, për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, andaj

D Ë N O H E T

Me dënim me gjobë në larësi prej **100 (njëqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në kuptim të nenit 163p. 3 të LK.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi l pika 6, të LMK-së.

Nga një kopje e aktgjykimit t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

A.P.K-ja, në Gjilan, me datën **22.09.2021**, ka paraqitur kërkesën me nr. **165/21**, për inicimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të lartshënuar dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ftoi të pandehurin me ftesë për datë **16.03.2022**, që të paraqitet në gjykatë, për të dhënë mbrojtjen e tij mirëpo edhe pse ftesën me rregull e ka pranuar mosardhjen nuk e ka arsyetuar andaj gjyqtari mori aktgjykim në mungesë konform nenit 48 pika 2, pasi që bindshëm vepra kundërvajtëse vërtetohet nga fletëparaqitja në shkresat e lëndës dhe nga përshkrimi i personit zyrtar për vendin e ngjarjes.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike mori në pyetje edhe personin zyrtar, pylltarin N.RR, në cilësinë e dëshmitarit i cili deklaroi se është e vërtetë se me datë **10.09.2021**, në orën 14:10 min, të lartpërmendurën e kam takuar në territorin e fshatit Demiraj, në rrugë duke transportuar dru bingu të njoma, të pa vulosura dhe pa fletëpercejllje në sasi prej 1.25 m³, me diametër 15-25cm, me gjatësi 1 m, dhe i transportonte me Kamionet ".....", me targa....., e që i ka shkaktuar dëm Agjencionit Pyjor në shumë prej **156.25 euro**.

Andaj gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe deklaratës së dëshmitarit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundërvajtëse prerje dhe-transportimi ilegal i druve, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **36 paragrafi 7**, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr- 2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës të aprovuar nga Kuvendit i Kosovës, për të cilën të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit, pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 p 1 të LMK-së, dhe të njëjtit i shqiptoi këtë dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, me bindje se edhe me një dënim të këfillë do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla kundërvajtëse.

Numri i lëndës: 2021:223781
Datë: 05.07.2022
Numri i dokumentit: 03201673

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej 5 €, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi I pika 6, të LMK-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Kundërvajtje,
Me datë 05.07.2022**

**Zyrtarja Ligjore,
Erzë Mustafa**

**Gjyqtari
Menderes Behluli**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.